



Tiranë, 20 Nëntor, 2009

Nr.Prot.268

## **LETËR INFORMATIVE TË RINJTË SHQIPTARË PA KUJDES PRINDËROR/JETIMË**

**Drejtuar:**

**Z. Sali Berisha  
Znj. Jozefina Topalli  
Z. Spiro Ksera  
Z. Myqerem Tafaj  
Z.Ferdinand Xhaferi**

**Kryeministër i Shqipërisë  
Kryetare e Kuvendit  
Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta  
Ministër i Arsimit dhe i Shkencës  
Ministër i Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve**

**Në vëmendje të : UNICEF  
Shërbimit Social Shtetëror  
Pushtetit Lokal  
OJF-ve  
Massmedia-s**

I Nderuar Z.Kryeministër,  
Të nderuar Zotërinj dhe e Nderuar Zonjë,

SOS Fshatrat e Fëmijëve e mbështetur nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe rrjetit të të rinjve përmes kësaj letre shpreh shqetësimin për situatën e të rinjve pa kujdes prindëror/jetimë të cilët largohen nga përkujdesi alternativ.

Në kuadër të 20 Nëntorit, e përcaktuar si dita e celebrimit të të drejtave të fëmijëve, ky grupim i dërgon këtë letër institucioneve qeveritare, përfaqësuesve të shoqërisë civile për sensibilizim ndaj kësaj çështje.

Situata e të rinjve pa kujdes prindëror/ jetimë të cilët dalin nga format e përkujdesit rezidencial apo forma të tjera private është vërtet alarmante.

Faktet tregojnë se të rinjtë shqiptarë pa kujdes prindëror, largohen nga institucionet rezidenciale në moshë shumë të hershme 15 vjeç, ku ende sipas Konventës përkufizohen me termin “fëmijë”.

**Këta të rinj vendosen në konviktet e shkollave të mesme profesionale por nuk ka asnjë strukturë sociale mbështetëse e monitoruese në shërbim të tyre përgjatë moshës 15-18 vjeç.**

**Aktualisht një pjesë e konsiderueshme e tyre jetojnë ende në konvikt përgjatë gjithë jetës së tyre në kushte minimale dhe me pagesë të ulët ekonomike.**

Edhe të rinjtë që dalin nga konviktet apo nga OJF përballen në moshë të hershme (18 vjeç )me jetesë të vështirë dhe sfida madhore lidhur me strehimin, punësimin dhe jetesën e tyre në pavarësi.

Fëmijët që janë në përkujdesje janë të arsimuar dobët, të papunë, të pastrehë, me asistencë minimale ekonomike dhe janë më të ekspozuar ndaj sjelljeve me risk e më të prekura nga çështjet e shëndetit mendor.

Konventa e të Drejtave të Fëmijëve përcakton se **fëmijët kanë nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje familiare.** Kushtetuta e Shqipërisë përcakton gjithashtu **mbrojtjen e veçantë që merret përsipër nga shteti për fëmijët që kanë humbur kujdesin prindëror.**

*Faktet e mësipërme tregojnë qartë shkeljen e të drejtave të të rinjve pa kujdes prindëror/jetimë dhe papranueshmërinë e faktit që fëmijët jetimë shqiptarë të moshës 15 vjeç të përballen me pavëmendjen dhe mungesën e shërbimeve*

Në përputhje me këto fakte, besojmë se ky është një fenomen që duhet të konsiderohet me prioritet nga institucionet qeveritare dhe strukturat përkatëse.

*Është e nevojshme të zgjatet koha e qëndrimit në përkujdesje, të krijohen qendra pritëse për të rinjtë jetimë e grupmoshës 15-18 vjeç, të krijohen shërbime për këta të rinj për t'i aftësuar ata për jetesën e pavarur duke investuar te edukimi, kujdesi me formë familje, trainimi profesional dhe veëanërisht punësimi i tyre.*

Besojmë në vëmendjen tuaj,  
Me respekt,



